



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:064206

Datë: 08.08.2023

Numri i dokumentit: 04564392

**PKR.nr.885/20**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Krimeve të Rënda**—në përbërje nga Kryetarja e trupit gjykues – Gjyqtarja Alltn Murseli, anëtarët – gjyqtarët profesional, Gazmend Bahtiri dhe Gëzim Ademi, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.S, për shkak të veprave penale Dhunimi nga neni 230 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 pika 3.3 të KPRK-së, Ngacmimi Seksual nga neni 183 paragrafi 1 të KPRK-së dhe Prezantimi i rremë si person zyrtar nga neni 409 paragrafi 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, PP/I.nr.95/2019, të datës 29.09.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të mbyllur për publikun, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurorja e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Merrushe Llugini, e dëmtuara K.S, me përfaqësuesin e saj sipas autorizimit av.Arbër Guta,i akuzuari R.S, me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av.Fitim Malokaj, me datën 06.07.2023 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datën 04.08.2023 përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **I akuzuari:**

R.S, nga i ati Xh, e ëma Xh , e vajzërisë S,i lindur më ..., në fshatin ... Komuna Obiliq, Rr. "...", ka të kryer shkollën e mesme teknike, i martuar babë i dy fëmijëve ,i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

#### **Sepse:**

- I.** Më datë 05.12.2018 rreth orës 19:30, në parkingun e Super Marketit "I..." i cili gjendet afër QKUK-së në Prishtinë, derisa e dëmtuara K.S ishte duke qëndruar në veturë bashkë me të dashurin B.A duke bere dashuri ka ardhur i akuzuari R.S, duke u prezantuar si polic e kishte detyruar te dal nga vetura të dëmtuarën K. duke i thënë se ti duhet te vish me mua për te dërguar ne shtëpi se ti po dukesh e mitur, ndërsa B.A duke i thënë juve po ju presin policia

poshtë, po ashtu i akuzuari kishte detyruar të dëmtuarën e lartcekur për ta përcjellë në shtëpinë e saj dhe i njëjti duke përcjellë e dërgon në një garazhe-bodrum te banesave në Lagjen "...” ne Prishtinë, duke e shfrytëzuar situatën në të cilën ishte e dëmtuara e pambrojtur dhe kur siguria e saj ishte në rrezik pa dëshirën e saj, ka kryer marrëdhënie seksuale me dhunë,-

- me këtë ka kryer veprën penale **Dhunimi nga neni 230 paragrafi I lidhur me paragrafin 3 pika 3.3 të KPRK-së.**

**II.** Me datë 11.05.2020 rreth orës 15:30, në parkingun e Super Marketit "I..." i cili gjendet afër QKUK-së në Prishtinë, derisa e dëmtuara P.M ishte duke qëndruar se bashku me te dashurin e saj SH.D, i akuzuari R.S, duke u prezantuar si person zyrtar policor ka arritur ta mashtroj viktimiten dhe ta detyroj qe te ndahet nga i dashuri me qellim kinse ta përcillte deri te stacioni policor për arsye të pandemisë Covid-19, e në vend të kësaj e ka dërguar në një vend të errët garazhe-bodrum te banesave në Lagjen "...” ne Prishtinë, duke e shfrytëzuar situatën në të cilën ishte e dëmtuara e ngacmon seksualisht duke e prekur në pjesët intime të trupit, e puthë dhe më pas e ka detyruar pa vullnetin e saj te zhvishet nën pretekstin se do ti bëj një analize për te vërtetuar virusin Covid-19 dhe të dërgohet në karantinë,-

- me këtë ka kryer veprën penale **Ngacmimi Seksual nga neni 183 paragrafi I të KPRK-së.**

**III.** Në kohën dhe vendin si në dispozitivin e parë (I) dhe të dytë (II), i akuzuari R.S prezantohet rrejtshëm si person zyrtar-polic K.S dhe P.M e me këtë rast e ka detyruar te dëmtuarën P.M që të ndahet nga i dashuri SH.D, me qellim kinse ta përcillte deri te stacioni policor për arsye se e njëjta kishte dalur jashtë orarit pa dorëza dhe maskë të pandemisë Covid-19, e ne vend te kësaj e ka dërguar në një vend të errët garazhe-bodrum te banesave në Lagjen ... ne Prishtinë dhe pas kryerjes së ngacmimit i njëjti i kishte marr 20 € të dëmtuarës-

- me këtë ka kryer veprën penale **Prezantimi i rremë si person zyrtar nga neni 409 paragrafi 2 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të neneve të lartcekura dhe neneve 2; 4; 7; 17; 21; 41; 42; 43; 45; 46; 73; 74 dhe 83 të KPRK-së dhe neneve 358, 364 dhe 365 të KPPK-së, të akuzuarin e gjykon dhe i:

## CAKTON

**I. Për veprën penale Dhunimi nga neni 230 paragrafi I lidhur me paragrafin 3 pika 3.3 të KPRK-së nga dispozitivi I, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vitesh,**

**II. Për veprën penale Ngacmimi Seksual nga neni 183 paragrafi I të KPRK-së nga dispozitivi II, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti,**

**III. Për veprën penale Prezantimi i rremë si person zyrtar nga neni 409 paragrafi 2 të KPRK-së nga dispozitivi III , dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe dënim me gjobë prej 500 (pesëqind euro),**

Konform nenit 80, par.2, pika 2.2 të KPRK-së, të njëjtin e:

## G J Y K O N

- **Me DËNIM UNIK me BURGIM në kohëzgjatje prej 8 (tetë) viteve** i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe
- **DËNIM ME GJOBË prej 500 (pesëqind euro)**, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim bëhet i plotfuqishëm. Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgim duke llogaritur çdo 20 (njëzet) Euro me një ditë burgim.
- Në dënimin e shqiptuar me burgim, të akuzuarit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak **prej datës 05.06.2020 e deri me datë 16.11.2020**, në atë mënyrë që një (1) ditë e qëndrimit në paraburgim apo arrest shtëpiak do të barazohet me një (1) ditë burgim.
- Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale aq sa do të llogaritet sipas shpenzimitorës përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 300.00€ (treqind euro), si dhe në emër të taksës për programin e kompensimit të viktimave të krimit shumë 50.00 € (pesëdhjetë euro), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
- Palët e dëmtuara K.S dhe P.M, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest te rregullt juridiko civil.

## Arsyetim

### Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda me aktakuzën PP/I.nr.95/2019, të datës 29.09.2020, ka akuzuar të akuzuarin R.S, për shkak të veprave penale Dhunimi nga neni 230 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 pika 3.3 të KPRK-së, Ngacmimi Seksual nga neni 183 paragrafi 1 të KPRK-së dhe Prezantimi i rremë si person zyrtar nga neni 409 paragrafi 2 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestarë ku i akuzuari R.S, është deklaruar i pa fajshëm sa i përket veprës penale Dhunimi nga neni 230 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 pika 3.3 të KPRK-së, ndërsa për veprat tjera Ngacmimi Seksual nga neni 183 paragrafi 1 të KPRK-së dhe Prezantimi i rremë si person zyrtar nga neni 409 paragrafi 2 të KPRK-së ka pranuar fajësinë, të cilin pranim e ka bërë në vullnet të plotë, andaj gjykata me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë për këto vepra penale, ndërsa shpalljen e ka pezulluar deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur në vazhdim seancat e shqyrtimit gjyqësorë për veprën penale Dhunimi nga neni 230 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 pika 3.3 të KPRK-së, ndërsa pas leximit të aktakuzës, me rastin e deklarimit të akuzuarit lidhur me çështjen e fajësisë në kuptim të nenit 321 par. 1 të KPRK-së, i njëjti ka deklaruar se nuk ndihet fajtor dhe nuk e pranon fajësinë, pasi që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë, gjykata duke u bazuar në nenin 323 par. 1 nën paragrafi 1.2 të KPRK-së, ka vazhduar me fjalën hyrëse, me prezantimin e provave personale dhe materiale dhe me fjalën përfundimtare të palëve.

### Fjala përfundimtare e palëve

Prokurorja e Shtetit fjalën përfundimtare e ka dorëzuar në formë të shkruar dhe të elaboruar edhe verbalisht në seancën e shqyrtimit gjyqësor ku i ka përmbledhur dhe përshkruar provat personale dhe materiale të cilat argumentojnë faktet në lidhje me veprimet e të akuzuarit të përshkruara si në dispozitiv të aktakuzës, dhe përfundimisht gjykatës i ka propozuar që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit dhe me rastin e marrjes së vendimit të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës fjalën përfundimtare e ka dorëzuar në formë të shkruar dhe e ka elaboruar edhe verbalisht në seancën e shqyrtimit gjyqësor duke i kërkuar gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

### Pretendimet e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij,

Mbrojtësi i të akuzuarit R.S, Av. Fitim Malokaj, në fjalën përfundimtare ka deklaruar fjalën përfundimtare e ka përgatitur me shkrim dhe e ka elaboruar në seancë, duke konsideruar se nuk është provuar aktakuza e prokurorisë dhe gjykatës i ka propozuar të akuzuarin ta liroj nga Aktakuza.

I akuzuari R.S, në fjalën përfundimtare deklaroj se e përkrahë fjalën përfundimtarë të dhënë nga mbrojtësi i tij dhe nuk ka tjetër se çfarë të shtoj.

Provat e administruara dhe të vlerësuara

- Gjykata lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike ka administruar provat siç janë dëshmitë e dëshmitarëve K.S dhe B.A, si dhe provat materiale:

- Raporti i ekzaminimit te mjeko ligjor te ministrisë drejtësi me nr. ...i datës 06.12.2018 i cili ekzaminim është bere për te dëmtuarën K.S
- Raporti i ekspertimit të Agjencisë se Kosovës për Forenzikë i dt.01.09.2020,
- Raporti i ekspertimit të Agjencisë se Kosovës për Forenzikë i dt. 13.07.2020,
- Raporti i te AKKF i date 23.10.2019,
- Foto dokumentacioni dhe shkresat e tjera në lëndë.
- E kaluara kriminale të akuzuarit R.S.

Dëshmitarja K.S, në dëshminë e saj të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 08.05.2023 ka deklaruar se ka qenë në shkollë ne B... dhe në ora 4 mbas dite pasi që e ka kryer mësimin është kthyer me autobusin e shkollës deri te qendra tregtare dardha, pasi që ka pasur me u taku me Burimin i cili ka qene një ish partner, me të cilin është takuar te parkingu i...te rrethi spitalit, ku kanë qëndruar në veturë dhe nuk ka qenë here e pare qe janë takuar. Gjatë qëndrimit aty kanë qenë duke kryer marrëdhënie seksuale edhe ne atë momente ka ardhur i akuzuari, me drita – me bateri te dorës pasi që ka qenë terr, ka ardhur te vetura direkt, është afruar te dritarja e veturës, ka dashtë një here me i marr para, prej B. dhe prej saj pasi që kanë qenë në një vend publik duke kryer marrëdhënie seksuale, që të dy kanë qenë të frikësuar, dhe i akuzuari i ka pare qe janë duke u frikësuar dhe është ushqyere prej frikës së tyre dhe i njëjti ka hipur menjëherë ne veturën e tyre. Pastaj dëshmitarja ka nis me u vesh ndërsa i akuzuari edhe B. kanë qenë përpara dhe i ke thënë B. se ty është duke të pritur poshtë polica -patrulla kurse dëshmitares i ka thënë qe do ta dërgoj te shtëpia për me ta kontrolluar se i është dukur e mitur. E ka zbrit prej veturës dhe o ka thënë B. tash takohem dhe ai ma ka zgjatur dorën dhe i ka thënë takohem, pastaj është nisur me te akuzuarin ku kanë zbrit poshtë shkallëve dhe e ka dërguar poshtë rrugës, përball i... deri në d... dhe gjatë gjithë kohës ka menduar se i njëjti është polic, kurse i njëjti gjatë tërë kohës ka folur në telefon me një grua dhe e ka vërejtur që dëshmitarja frikësohet prej policisë. Ka qenë e bindur se i njëjti është polic dhe i ka zbatuar kërkesat e tij ndërsa kur i ka kërkuar ID i njëjti nuk ja ka prezantuar. Tutje ka treguar se e ka shti në një hyrje të ndërtesës për ta kontrolluar, pasi që ishte i frikësuar se ishte e mitur dhe i ka kërkuar letër me këqyre me pallomë me këqyr për sperme se nuk e ka kuptuar as vet çka ka dashtë, kurse kur e ka shti te ajo hyrja me kontrollu e ka parë një burri tu qa dru dhe i njëjtit ka thonë se nuk bon këtu dhe pastaj kanë dal për te hyrja tjetër e ma andej rrugën teposhte neper zebra ka çerdhja në lagjen D..., te shkolla D..., te poshtë dhe e ka shti në një garzh ku ka pas shumë garazhe. E njëjta ka

thënë se nuk ka kërkuar ndihmë sepse ka menduar se i akuzuari është polic. Por kur e ka futur tek garazha dhe i njëjti i ka kërkuar të zhvishet, dëshmitarja i ka kërkuar ID dhe i njëjti pastaj e ka dhunuar duke e shtyrë me force për muri, ja ka zhveshur trenerkat e kthyer me fytyrë për muri, nuk e ka lënë me lëviz dhe e ka kryer aktin seksuale në këmbë. E njëjta ka qenë e shokuar dhe nuk ka dite se si të veprojë. Nuk ka qene i dhunshëm gjate kohës deri sa e ka dërguar në garazh dhe atje nuk është që e ka goditur por se ka lënë me lëviz. Dhunimi nuk ka zgjatur shume, maksimumi kanë qenë 5 ose më së shumti 7 deri në 8 minuta. Kur i akuzuari e ka kryer dhe ka qenë duke u veshur e ka shfrytëzuar rastin për të ikur dhe e ka thirrë në telefon B. duke i thënë ky personi nuk është polic. Pas 2 viteve qe ka ndodhur rasti, rast i njëjti i ka ndodhur edhe vëllait të saj me femër tij me te njëjtin person, femrës së vëllait të saj i ka thënë njëjtat fjalë sikur me të, ka fol folur me te njëjtin presione si ka fol asaj dhe aty ka pas besimin edhe familjes edhe policisë, se policia nuk e ka besuar dhe e kanë pyetur a je shit me pare, edhe polici qe ka ardhur në shtëpinë natën qe është dhunuar shoqes së saj i ka thënë mos i beso kësaj se kjo u kon shtatzëne. Tutje ka deklaruar se e ka kërkuar personin që e ka dhunuar në rrjete sociale dhe të njëjtin e ka gjetur me emrin R.TH por është fjala për personin e njëjtë që është i akuzuar dhe i cili e ka dhunuar.

Dëshmitari B.A, në dëshminë e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 24.06.2023, ka deklaruar se data e rastit konkret nuk i kujtohet por i kujtohet qe është takuar me K. me të cilën kanë kontaktuar në snapchat dhe pastaj janë takuar afër spitalit, tek parkingu për vetura gjegjësisht I... Ka qene me veture ku ka shkuar dhe e kam marre K., kanë hypur lartë në paraking, ka qenë mbrëmje, errësirë. Kanë qëndruar mbrapa në veture dhe ka ardhur një person me bateri, kinse polic, i cili ju ka thënë çka jeni tu bo këtu a dini çka jeni tu bo ne parking dhe nga mbrapa ka dal përpara në veturë kurse K. ka mbet mbrapa në veturë, i njëjti ju ka thënë qe është polic dhe nuk kishke uniforme pastaj ka dal ne anën tjetër dhe ka hypur në veture pjesën e përparme. I njëjti ju ka thënë se do ju dërgoj ne stacion policor kurse dëshmitari i ka thënë a ka mundësi mos me i dërgu ne stacion sepse babën e K. e njuhë dhe nuk ka dashur të ballafaqohet me prindin e saj. Tutje i akuzuari i ka thënë qe te voziti dhe kur ka filluar me vozite kanë komunikuar dy tri fjale dhe i njëjti i ka dërguar ne një qosh parkingu dhe ka dalur prej veturës dhe ka filluar me fol ne telefoni por nuk i kujtohet saktë se çfarë ka folur në telefon. Pas bisedës telefonike i njëjti ju ka thënë se nuk po ju qoji ne stacion, por i ka thënë ta merr veturën dhe nisu për Gjilan. Nga veture ka dal edhe K. të cilës dëshmitari i ka thënë qe si te ndahesh prej polici do ta pres, edhe ka marre veture ka shkuar poshtë ku është një trafik qe rrinë sigurimi në fillim te hyrja edhe e ka pyet a ka sigurimi nalt apo polic dhe dikush i ka thënë se nuk ka kurrjë këtu dhe ka filluar ta thërras K. për mbi 30 here apo 40 here, e ka kërkuar neper parking e ka lyp edhe me zë por nuk e ka lajmëruar askush. Tutje ka deklaruar se i ka shkruar K. mesazh në snap duke i thënë largohu prej atij personi se nuk është as polici as kurrjë sepse e ka pyetur sigurimin e parkingut te I... dhe nuk e ka hapur telefoni dhe është nisur për Giilan. Më vonë e ka thirr K. duke qajtur dhe i ka treguar për afërsisht se çka ka ndodhur se si e ka marre ai personi dhe e ka dërguar te do garazha në D..., ka thënë qe ka kryer marrëdhënie me dhune, ka kryer marrëdhënie nga mbrapa dhe nuk ka dashur ne detaje te dijë sepse e ka pasur femer edhe ajo nuk është ndier mire. Personi që është i akuzuar është 99.99 për qind personi që ka qene atë natë dhe është shtirur si polic.

Mbrojtja e te akuzuarit.

**I akuzuari R.S** në mbrojtjen e paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se të dëmtuarën K.S e njuh prej vitit 2017 ose 2018, pasi që kanë pasur lidhje dashurie me të. Ndërsa në ditën kritike ka mohuar të ketë qenë tek parkingu i I... por me K. është takuar atë ditë dhe e ka marrë te ... në Dardani e ka marrë me kombi dhe kanë shkuar te R...në rrugë për Ferizaj dhe atë ditë ka kryer marrëdhënie seksuale me K. te R...ne hotel dhe janë kthyer mbas 2 ore ose 3 ore dhe duke ardhë janë fjalosur rrugës me K. e cila e ka marre telefoni e tij ne dore dhe u hi në një follder dhe i ka pare foto e fëmijëve te tij dhe në atë moment i ka treguar qe është i martuar ndërsa pasi që kanë arritur një mobile shop në U... aty ka qel derën kombit dhe ka zbritur poshtë nga kombi dh i ka thënë se ki me ma pa sherrin besën po ta dha. Tutje ka deklaruar se B.A e njuh qe nga viti 2015 dhe janë njoftuar në baze te shoqërisë, pasi që e njuh babën se K. , E.S dhe kanë pirë kafe së bashku. Po ashtu ka deklaruar se në ditën kritike gruan e tij e ka pas të shtrirë në spitalin pediatrik në Prishtinë.

Arsyetimi i vendimit mbi faktet e vërtetuara dhe jo të vërtetuara

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate Arsyetimi nuk ka për qëllim të jetë përsëritje e materialit të provave, funksioni i tij është ta mundësojë të kuptuarit e vendimit lidhur me vërtetimin ose jo të fakteve. Fillimisht do të bëhet vlerësim i fakteve të përgjithshme mbi secilin lloj të provës dhe pastaj do të bëhen edhe disa referime specifike për secilin fakt, apo së paku për grumbuj faktesh. Rreth sferës së arsyetimit, në referim të nenit 6 të konventës evropiane për të Drejtën në Gjykim të Drejtë dhe praktikës së ndërtuar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, arsyetimi i vendimeve gjyqësore – Sipas praktikës juridike që reflekton një parim të lidhur me ndarjen e duhur të drejtësisë, aktgjykimet e gjykatave duhet t'i shpalosin qartë arsyet mbi të cilat ato bazohen, Vendimet e arsyetuara i shërbejnë qëllimit të demonstrimit palëve se ata janë dëgjuar, duke kontribuar kështu në një pranim më të gatshëm të vendimit nga ana e tyre. Përveç kësaj, ato i obligojnë gjykatën që ta bazojnë arsyetimin e tyre në argumentet objektive si dhe t'i ruajnë të drejtat e mbrojtjes. Megjithatë, shkalla e detyrës për të dhënë arsyetim ndryshon sipas natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet në aspektin e rrethanave të rastit. Ndonëse gjykatat nuk janë të obliguara të japin përgjigje të hollësishme për secilin argument të ngritur, por duhet të jetë e qartë nga vendimi se janë trajtuar çështjet thelbësore të rastit. Gjykatat duhet t'i cekin me qartësi të mjaftueshme bazat në të cilat i bazojnë vendimet e tyre me qëllim që t'i mundësohet një palë ndërgjyqëse që t'i ushtrojë të drejtat për ankesë në raste të pakënaqësisë me vendimin e gjykatës, andaj nga kjo rezulton se gjykatat janë të obliguara të japin sqarime në lidhje me provat relevante të cilat vërtetojnë gjendjen faktike të dispozitivit të aktgjykimit, por jo edhe domosdoshmërisht edhe provat të cilat janë shqyrtuar në shqyrtim gjyqësorë e që nuk kanë fuqi provuese qoftë direkte apo rrethanore në lidhje me rastin i cili është objekt i këtij gjykimi, ashtu që gjykata në arsyetimin e këtij aktgjykimi do ti sqarojë të gjitha provat relevante secilën veç e veç si dhe në lidhmëni me njëra tjetrën për të arsyetuar vendimin e gjykatës.

Gjetjet e Gjykatës.

Gjykata pas administrimit të provave personale dhe materiale në shqyrtim gjyqësor, duke u bazuar në nenin 360 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë, vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarve si dhe ato në favor të tyre, duke iu mundësuar të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhmëni më njëra tjetrën si tërësi dhe si rezultat i vlerësimit të tyre, është provuar se tani i akuzuari R.S ka kryer veprën penale Dhunimi nga neni 230 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 pika 3.3 të KPPRK-së.

Për gjykatën nuk ishte kontestuese që e dëmtuara K.S dhe B.A njihen mes tyre pasi që B.A është shok i babait të dëmtuarës si dhe e dëmtuara dhe B.A kanë pasur lidhje dashurie në mes tyre. Të njëjtit janë marrë vesh që të takohen sëbashku me datën 05.12.2018 dhe kanë qenë duke qëndruar në veturën e B.A në parkingun e marketit I... i cili gjendet tek rrethi i spitalit në Prishtinë.

Po ashtu nuk ishte kontestuese se të njëjtit kanë kryer marrëdhënie seksuale me dëshirën e tyre në veturën e B.A dhe gjatë kohës sa kanë qëndruar aty, ka ardh i akuzuari me një bateri në dorë duke u shtirur si polic dhe duke i kërkuar llogari se pse janë duke kryer marrëdhënie seksuale në vend publik. Pastaj i akuzuari duke vazhduar aktrimin e tij kinse është zyrtar policor dhe duke u treguar kinse zemër mirë, të dëmtuarës dhe dëshmitarit i ka thënë se nuk do ti lajmërojë dhe dërgoj në stacion policor por dëshmitarit i ka thënë të largohet me veturën e tij drejt vendit ku jeton, kurse të dëmtuarën e ka marrë me vete duke i thënë se dyshon që është e mitur dhe do ta dërgoj në shtëpinë e saj.

Gjykata këtë gjendje faktike e vërtetoi nga vetë deklaratimet e të dëmtuarës dhe të dëshmitarit B.A të cilët në seancat e shqyrtimit gjyqësor deklaruan se janë marrë vesh së bashku për tu takuar dhe kanë shkuar në parkingun e I... dhe gjatë kohës sa kanë qëndruar aty kanë kryer marrëdhënie seksuale së bashku me pëlqimin e tyre dhe ndërkohë ka ardh i akuzuari i cili është shtirur si polic dhe nga frika prej tij, pasi që kanë qenë të vetëdijshëm se janë duke kryer marrëdhënie seksuale në një vend publik, duke qenë të bindur se i njëjti është zyrtar policor i janë nënshtruar vullnetit të të akuzuarit dhe i njëjti dëshmitarin e ka urdhëruar të largohet kurse të dëmtuarën e ka marrë me vete kinse për ta dërguar në shtëpinë e saj.

Dëshmisë së të dëmtuarës - dëshmitarës, gjykata ja fali besimin e plotë sepse këtë deklaratim gjykata e vlerësoi si të besueshmë, kjo për faktin se deklaratimi i saj ka koherencë me deklaratimet tjera të cilat i ka dhënë në procedurat e më hershme lidhur me këtë rast, e po ashtu edhe për faktin se deklaratimi i saj ka lidhje logjike me provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, sikurse janë ekspertiza mjeko ligjore, CD, thirrja e ndihmës së shpejt, si dhe fotodokumentacioni. Po ashtu gjykata ja fali besimin e plotë edhe dëshmitarit sepse dëshmia e tij është në lidhshmëri të plotë faktike, logjike dhe të njëjtën e konstatoj si të besueshme.



Për gjykatën kontestues ishte fakti nëse i akuzuari pasi është larguar nga parkingu i I... së bashku me të dëmtuarën, a e ka dërguar të njëjtën në një nga garazhat në lagjen ...dhe a ka kryer marrëdhënie seksuale me të pa dëshirën e saj.

Gjykata ka analizuar veprën penale të Dhunimit nga neni 230 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 pika 3.3 të KPRK-së, elementet dhe figurën e kësaj vepre penale. Kodi Penal NR. 04/L-082, në nenin 230, paragrafi 1 ka përcaktuar se “*Kushdo që detyron personin tjetër për të kryer akt seksual pa pëlqimin e personit të tillë, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet,*” kurse si formë të kualifikuar e ka përcaktuar në paragrafin 3 “*Kushdo që detyron personin tjetër për të kryer akt seksual në një ose më shumë nga rrethanat në vijim, dënohet me burgim prej pesë (5) deri në dhjetë (10) vjet:*”, ndërsa pika 3.3: *duke shfrytëzuar situatën në të cilën personi është i pambrojtur dhe ku siguria e tij është në rrezik.*”

Dhunimi është një ndër veprat më të rënda kundër integritetit seksual. Objekti, respektivisht subjekti pasiv i kësaj vepre penale është çdo person pa marrë parasysh përkatësin gjinore. Forma themelore e kësaj vepre penale konsiston në detyrimin e personit tjetër për të kryer akt seksual pa pëlqimin e tij. Vepra penale nga paragrafi 1 është vepër e përbërë e cila përbëhet nga akti seksual dhe nga ndonjë formë e detyrimit për ta kryer aktin seksual pa pëlqimin e subjektit pasiv-viktimës. Për të ekzistuar kjo vepër penale, patjetër duhet të mos ekzistojë pëlqimi i subjektit pasiv-viktimës për akt seksual ose për ta vazhduar atë. Ndërsa tek forma e kualifikuar e paraparë në nën paragrafin 3 të këtij neni, kryhet duke e shfrytëzuar një situatë në të cilën personi është i pa mbrojtur dhe siguria e saj është në rrezik.

Gjykata duke i analizuar provat personale dhe materiale të propozuara nga ana e Prokurorisë Themelore në Prishtinë e të cilat i ka administruar në shqyrtimin gjyqësor, i ka vlerësuar si prova të pranueshme andaj i ka administruar si të tilla, e të cilat qojnë gjykatën në konkludim se besueshmëria në to dhe shkalla e arsyeshmërisë me rrethanat e konkrete të rastit, të cilave kjo gjykatë u kushtoi besim të plotë, prandaj gjykata gjen se aktakuza ka prova që në mënyrë të padyshimtë vërtetojnë faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale të Dhunimit nga neni 230 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 pika 3.3 të KPRK-së dhe se në veprimet e tij përmbushen të gjitha elementet e kësaj vepre penale, ashtu që i akuzuari duke shfrytëzuar gjendjen apo momentin intim në të cilën kanë qenë e dëmtuara dhe dëshmitari, gjegjësisht duke kryer marrëdhënie seksuale në vend publik, duke u shtirur si zyrtar policor dhe duke i frikësuar të njëjtit se për veprimet e tyre do ti raportojë dhe dërgoj në polici, ka marrë të dëmtuarën e cila ka qenë e re në moshë dhe e frikësuar nga ai, e ka dërguar në garazhat në lagjen ... të cilat garazha kanë qenë të zbrazëta, të errëta dhe duke shfrytëzuar frikën e saj ka kryer marrëdhënie seksuale pa dëshirën e saj ashtu që kur e ka futur tek garazha dhe i njëjti i ka kërkuar të zhvishet, e dëmtuara duke qenë e habitur me kërkesën e tij, i ka kërkuar ID për të vërtetuar se i njëjti është zyrtar policor dhe i njëjti duke e shtyrë me force për muri, ja ka zhveshur trenerkat e ka kthyer me fytyrë për muri, nuk e ka lënë me lëviz dhe e ka kryer aktin seksual në këmbë. E dëmtuara duke qenë e shokuar, e pafuqishme të reagojë apo të mbrohet nuk ka mundur ti rezistojë të njëjtit i cili e ka dhunuar dhe pas kryerjes së marrëdhënies seksuale e njëjta e ka shfrytëzuar rastin kur i akuzuari ishte duke u veshur dhe ka ikur nga ai duke e telefonuar dëshmitarin B.A të cilit i ka treguar se si ka ndodhë rasti.

Gjykata këtë gjendje faktike e vërtetoi nga vetë deklarimi i të dëmtuarës e cila e ka përshkruar në mënyrë kronologjike rrjedhën e ngjarjes dhe veprimet e të akuzuarit, duke potencuar se i njëjti e ka shfrytëzuar frikën e saj duke qenë se i njëjti është shtirur si polic, për të kryer marrëdhënie seksuale pa dëshirën e saj. Gjithashtu edhe dëshmitari në dëshminë e tij ka deklaruar se kur është larguar e dëmtuara me të akuzuarin ka shkuar dhe ka pyet a ka sigurim lartë në parking apo polic dhe dikush i ka thënë se nuk ka kurrëgjë këtu, pastaj ka filluar ta thërras K.për mbi 30 here apo 40 here, e ka kërkuar nëpër parking, e ka kërkuar edhe me zë por nuk është lajmëruar askush, ndërsa më vonë, vetë e dëmtuara e ka thirr duke qajtur dhe i ka treguar përafërsisht se çka ka ndodhur se si e ka marrë ai personi dhe e ka dërguar të do garazha në Dardani duke i thënë që ky person e ka detyruar për të kryer marrëdhënie seksual me dhunë. I njëjti po ashtu ka potencuar se personi i akuzuar është personi që e ka marrë të dëmtuarën atë natë duke u shtirur si polic.

Dëshmitë e të dëmtuarës dhe dëshmitarit janë në lidhshmëri të plotë edhe me provat materiale, gjegjësisht nga Raporti i ekzaminimit të mjekësisë ligjore të Ministrisë së Drejtësisë me nr. ... i datës 06.12.2018 i cili ekzaminim është bërë për të dëmtuarën K.S, gjate ekzaminimit të jashtë është konstatuar që në regjionin e poshtëm të para hyrjes vaginal në ora 6 sipas akrepave të orës është konstatuar shqyerje lëkurorë dhe ndrydhje e indeve të butë të shoqëruar me mavijosje për rreth dhe nga kjo provë gjykata ka vërtetuar faktin se akti është kryer me dhunë ngase ka pas mavijosje si pasojë e penetrimit të dhunshëm.

Nga raporti i te AKKF i date 23.10.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se e dëmtuara ka kryer marrëdhënie seksuale me dy persona pasi që është dhënë konstatimi dhe mendimi përfundimtarë që vërteton që nga dëshmia K.S-1 dhe K.S-2, janë fituar profilet e përziera të ADN-së nga se paku dy persona të panjohur që është fjalë për këta dy persona që kanë pasur marrëdhënien seksuale që janë R.S dhe B.A.

Po ashtu nga Raporti i ekspertimit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë i datës 01.09.2020, është dhënë konstatimi dhe mendimi përfundimtarë që vërtetohet nga dëshmia RS-1 dhe RS-2 është nxjerr profil i ADN të R.S dhe sipas këtij konstatimi R.S nuk mund të përjashtohet si njeri nga kontribuesit e ADN-së në përzierjen e fituar nga dëshmitë K.S-1 dhe K.S-2.

Nga Raporti i ekspertimit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë i datë 13.07.2020, nga i cili konstatimi dhe mendimi përfundimtarë vërtetohet nga dëshmia e B.A-1 dhe R.S-2, është nxjerr profil ADN të B.A dhe i njëjti nuk mund të përjashtohet si njëri nga kontribuesit e ADN në përzierjen e fituar nga dëshmitë K.S-1, dhe K.S-2.

Gjykata këtyre ekspertizave, ia fali besimin e plotë, kjo për faktin se të njëjtat janë përpiluar mbi bazën e njohurive profesionale dhe shpjegojnë dëmtimet që ka pësuar e dëmtuara dhe me sa persona e njëjta ka kryer marrëdhënie intime.

Nga të gjitha provat personale dhe materiale, u vërtetua përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale të Dhunimit nga neni 230 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 pika 3.3 të KPRK-së dhe se në veprimet e tij janë përmbushur të gjitha elementet e kësaj vepre penale. Nga ekzaminimet mjekësore që i janë bërë të dëmtuarës del se e njëjta ka kryer marrëdhënie seksuale me dy persona dhe kjo gjendje faktike është në përputhje të plotë me

dëshminë e saj dhe me dëshminë e dëshmitarit të cilët e kanë pranuar se kanë kryer marrëdhënie intime mes tyre dhe gjithashtu vërtetohet se edhe i akuzuari ka kryer marrëdhënie intime me të dëmtuarën por pa pëlqimin e saj pra i njëjti e ka dhunuar të dëmtuarën.

Gjykata mori parasysh edhe sjelljen e mëparshme të kryesit i cili ka pranuar kryerjen e veprës penale të ngacmimit seksual që ka ndodhur në vitin 2020 pikërisht në vendin dhe mënyrën e njëjtë siç edhe ka ndodhë në rastin konkret të dhunimit. I akuzuari duke u prezantuar si person zyrtar policor, ka arritur ta mashtrij viktimën dhe ta detyroj që të ndahet nga i dashuri me qëllim kinse ta përcillte deri te stacioni policor për arsye të pandemisë Covid-19, e në vend të kësaj e ka dërguar në një vend të errët garazhe-bodrum të banesave në Lagjen "... " në Prishtinë. Po ashtu i njëjti ka pranuar edhe veprën penale të prezantimit të rremë ku prezantohet rrejshëm si person zyrtar-polic në mënyrë që të mashtrij dhe të shfrytëzoi frikën e krijuar për qëllime ngacmimit dhe në rastin konkret kryerjes së marrëdhënies seksuale me dhunë.

Gjykata gjen se të dyja rastet kanë ngjashmëri shumë të madhe në mes të tyre, pasi që veprimet e të akuzuarit pothuajse janë identike gjë që përforcon bindjen e gjykatës se i akuzuari ka kryer këtë veprë me dashje direkte dhe i njëjti ka arritur që përmes prezantimit të rremë si zyrtarë policor të ushtrojë ndikimin e tij tek e dëmtuara për ta dërguar në vende të errëta, përkatësisht në njërin nga garazhat e lagjes ...dhe ti kënaq epsheet e tij seksuale duke kryer marrëdhënie seksuale pa pëlqimin e saj.

#### Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit R.S i cili e ka mohuar se në ditën kritike ka qenë tek parkingu i I...dhe sa i përket pretendimeve të tij se me K. është takuar atë ditë dhe e ka marrë te ... në Dardani, e ka marrë të njëjtën me kombi dhe kanë shkuar te R...në rrugë për Ferizaj dhe atë ditë ka kryer marrëdhënie seksuale me K... në hotel tek R..., gjykata këtyre pretendimeve nuk ja fali besimin sepse janë në kundërshtim të plotë me provat personale dhe materiale të administruara në këtë shqyrtim gjyqësor.

Mendimi i gjykatës është se mbrojtja e këtyre të akuzuarit nuk ka mbështetje në asnjë provë të administruar, nuk është e bindshme dhe është e drejtuar kah evitimi i përgjegjësisë penale si dhe në kundërshtim me provat personale pasi që vetë e dëmtuara dhe dëshmitari kanë deklaruar se i akuzuari ka qenë personi që është shtirur si polic dhe e ka marrë të dëmtuarën dhe e ka dërguar tek garazhat në lagjen ... dhe po ashtu dëshmia e tij është në kundërshtim edhe me provat materiale të cilat kanë potencuar se në atë ditë e dëmtuara ka kryer marrëdhënie intime me dy persona.

### Vlerësimi i pranimi të fajësisë për veprat tjera penale

Lidhur me veprat penale për të cilat i akuzuari ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, gjegjësisht veprën penale Ngacmimi Seksual nga neni 183 paragrafi 1 të KPRK-së dhe Prezantimi i rremë si person zyrtar nga neni 409 paragrafi 2 të KPRK-së, gjykata ka marrë edhe mendimin e mbrojtësit të tij sipas autorizimit dhe mendimin e prokurorit të shtetit të cilët janë pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, andaj gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimi të fajësisë. Pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe ka mbështetje në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafi 1 të KPP. Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara në dispozitën e nenit 248 paragrafi 1 të KPPRK-së, lidhur me pranimin e fajësisë.

Nga deklarimi i të akuzuarit në shqyrtimin fillestar dhe nga pranimi i fajësisë u vërtetua se i njëjti me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin II dhe III të aktakuzës së ngritur ndaj tij, ka kryer veprat penale Ngacmimi Seksual nga neni 183 paragrafi 1 të KPRK-së dhe Prezantimi i rremë si person zyrtar nga neni 409 paragrafi 2 të KPRK-së.

### Vendimi mbi matjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarit, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, andaj për të akuzuarin nuk gjeti rrethana lehtësuese ndërsa si rrethanë rënduese gjeti shkallën e lartë të përgjegjësisë së tij pasi që i njëjti me dashje ka shfrytëzuar situatën dhe ka kryer marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën pa marrë pëlqimin paraprak të saj, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, i njëjti i ka shkaktuar dëm fizik dhe psikologjik të dëmtuarës duke i shkaktuar edhe trauma psikologjike, sjelljen e mëparshme të akuzuarit, i njëjti ka rënë ndesh me ligjin edhe më parë, ashtu që sipas Sistemit Qendrorë të Evidencës Penale i akuzuari R.S është gjykuar dhe dënuar për disa raste të ndryshme të kryerjes së veprave penale, pra është recidivist i veprave penale. Sipas evidencës penale i akuzuari figuron si person i dënuar në këto raste: Rasti P-.../2019 në Skenderaj, i plotfuqishëm me date 13.09.2018 vepra: 335 mashtrim dënimi: dënim me kusht 8 muaj në afat verifikimi prej 16 muaj, Rasti PM-.../2013 në Prishtinë plotfuqishmeria me date 24.03.2014 vepra: 193 dhunim dënimi : dënim me burgim 1 vit e 6 muaj, Rasti P-.../2017 ne Ferizaj plotfuqishmeria me date 29.08.2018 vepra: 335 mashtrim dënimi: dënim me burgim prej 3 muaj dhe gjobe 300 euro, Rasti P-.../2018 ne Gjakove plotfuqishmeria me date 08.05.2019 vepra: 325 vjedhje dënimi: dënim me gjobe 250 euro, Rasti P-.../2018 ne Prizren plotfuqishmeria me date 03.01.2019 vepra: 335 mashtrim dënimi: dënim me gjobe 400 euro dhe dënim me kusht 6 muaj ne afat verifikimi prej 1 viti, Rasti P-.../2018 ne Glllogoc plotfuqishmeria 21.02.2019 vepra: 335 mashtrim dënimi : Dënim me burgim prej 6 muaj dhe dënim me gjobe 400 euro, Rasti P-.../2018 ne Prizren plotfuqishmeria 24.12.2018 vepra; 188 lëndim i lehte trupor dënimi: dënim me kusht 3 muaj ne afat verifikimi prej 1 viti, Rasti P-

.../2018 ne Podujev plotfuqishmeria 29.08.2018 vepra: 335 mashtrim denim: denim me kusht 3 muaj ne afat verifikimi prej 1 vit dhe denim me gjobe 120 euro, Rasti P-.../2011 ne Glogoc plotfuqishmeria 04.04.2014 vepra: 261 mashtrim denimi: denim me gjobe 300 euro, Rasti P-358/2016 ne Prishtine plotfuqishmeria 10.12.2019 vepra:335 mashtrim denimi: denim me burgim prej 5 muaj dhe denim me gjobe 300 euro, Rasti P-.../2019 ne Suharek plotfuqishmeria 20.03.2020 vepra:313 vjedhje denimi: denim me gjobe 1200 euro, Rasti P-.../2017 ne Prishtine plotfuqishmeria 10.02.2020 vepra: 325 vjedhje denimi: denim me kusht 6 muaj ne afat verifikimi prej 1 viti dhe denim me gjobe 200 euro, Rasti P-.../2010 ne Prishtine plotfuqishmeria 23.03.2011 vepra; 161 kanosje denimi: denim me gjobe 250 euro, Rasti P-.../2019 ne Lipjan plotfuqishmeria 16.03.2020 vepra:335 mashtrim denimi: denim me kusht 3 muaj dhe 200 euro ne afat verifikimi prej 1 viti, Rasti P-.../2019 ne Prishtine plotfuqishmeria 03.03.2021 vepra :187 sulm denimi: denim me burgim prej 3 muaj, Rasti P-.../2018 ne Prishitne plotfuqishmeria 07.11.2019 vepra: 417 prezentim i rrem si person zyrtar denim: denim me kusht 6 muaj ne afat verifikimi prej 1 viti dhe denim me gjobe 200 euro, Rasti P-.../2019 ne Lipjan plotfuqishmeria 13.05.2021 vepra 335 mashtrim denimi: denim me kusht 5 muaj ne afat verifikimi prej 1 viti dhe denim me gjobe 200 euro, Rasti P-.../2018 ne Lipjan plotfuqishmeria 04.08.2021 vepra: 335 mashtrim denimi: denim me burg 3 muaj, Rasti P- .../2017 ne Kline plotfuqishmeria 19.10.2018 vepra 335 mashtrim denimi: denim me burgim 3 muaj dhe denim me gjobe 300 euro, Rasti P-2707/2017 ne Prishtine plotfuqishmeria 29.12.2017 vepra: 232 sulm seksual denim: denim me gjobe 300 euro, Rasti P-.../2021 ne Viti plotfuqishmeria 29.05.2023 vepra: 323 mashtrim denimi: denim me gjobe 400 euro dhe nga këto arsye gjykata i'a ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve duke qenë e bindur se me dënimin si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi ndëshkëimor në kuptim të preventives speciale dhe në këtë mënyrë do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe do të ndikojë në vetëdijesimin dhe përmbajtjen e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, çka është edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së.

#### Vendimi mbi shpenzimet e procedurës

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453, par. 1, të KPP-së ndërsa lidhur taksën për programin e kompensimit të viktimave u mor konform nenit 36 par 3, pika 3.2, të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit (Ligji nr. 08/L-109).

#### Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil u mor konform nenit 462 të KPPK-së.

#### Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit

Gjykata konform nenit 83 të KPK-së, në dënimin e shqiptuar të akuzuarit ja ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak.

Mbi bazën e të dhënave si më lart dhe konform nenit 364 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti i Krimeve të Rënda**  
**PKR.nr.885/20, të datës 04.08.2023**

**Kryetarja e trupit gjykues - gjyqtarja,**  
Alltn Murseli

---

**KESHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.